



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

---

KPPP.nr. 543/22

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtari Hasan Kryeziu, në çështjen përmbartimore të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me seli në Pejë, kundër debitorit GJ.L B.I “D.P.H” R..., NRB ....., me seli në Pejë, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbartimor P.nr.239/20 të datës 28.07.2020 të Përmbartuesit Privat Zija Bala, me seli në Pejë, jashtë seancës me datën 06.09.2022, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. APROVOHET pjesërisht prapësimi i debitorit GJ.L B.I “D.P.H” R..., dhe ANULOHET pjesërisht Urdhri për lejimin e përmbartimit P.nr.239/20 i datës 28.07.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, për pjesën e kamatës ligjore prej datës 12.11.2019 e deri në pagesën përfundimtare.
- II. MBETET NË FUQI pjesa tjetër e Urdhrit për lejimin e përmbartimit P.nr.239/20 i datës 28.07.2020, i lejuar nga Përmbartuesi Privat Zija Bala, me të cilën është caktuar përmbartimi, për pjesën e detyrimit kryesor në shumën prej 1,100.00 € (një mijë e njëqind euro).
- III. PËRFUNDOHET pjesërisht procedura përmbartimore e kreditorit Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ndaj debitorit GJ.L B.I “D.P.H” R..., sipas Urdhrit Përmbartimor P.nr.239/20 të datës 28.07.2020, për pjesën e kamatës ligjore prej datës 12.11.2019 e deri në pagesën përfundimtare.

A r s y e t i m

Kreditori, Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës ka parashtruar propozim për përmbarim kundër debitorit “GJ.L B.I “D.P.H” R..., me të cilën ka kërkuar përmbushjen e detyrimit sipas dokumentit përmbarues – Vendimit Nr. 271/19 të datës 12.11.2019, dhe të detyrohet debitori që në emër të masës ndëshkimore t’ia paguaj kreditorit shumën prej 1,100.00€ (një mijë e njëqind euro) me kamatë ligjorë duke filluar prej datës 12.11.2019 e deri në pagesën përfundimtare, me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe llogarive tjera ndihmëse deri në bartjen e shumës së cekur.

Përmbaruesi Privat Zija Bala, me seli në Pejë, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit Qeveria e Republikës së Kosovës - Ministria e Punës dhe Mirëqenies Sociale – Inspektorati i Punës, me datë 28.07.2020, ka lëshuar Urdhrin Përmbarimor P.nr.239/20, me të cilin ka lejuar përmbarimin në bazë të dokumentit përmbarues, Vendimit të Inspektoratit të Punës Nr. 271/19, të datës 12.11.2019 me të cilën është detyruar debitori që në afat ligjor t’ia paguaj kreditorit në emër të masës ndëshkimore shumën prej 1,100.00 € (një mijë e njëqind euro) me kamatë ligjore duke filluar prej datës 12.11.2019 e deri në pagesën përfundimtare, me ndalimin e mjeteve të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe llogarive tjera ndihmëse deri në bartjen e shumës së cekur.

Debitori GJ.L B.I “D.P.H” R..., brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim me shkrim, duke theksuar se masa e gjobës i është shqiptuar pa të drejtë, ankesa i është refuzuar si e pa pabazuar dhe se ka iniciuar konflikt administrativ lidhur me këtë çështje. Më tutje ka shtuar se gjoba i është shqiptuar për shkak të mos prezantimit të kontratave për dy punëtorët e tij gjatë inspektimit nga ana e inspektorëve në lokalin e tij, duke theksuar se i njëjti në atë moment nuk ka qenë në lokal, ndërsa kontratat e punëtorëve i ka pasur në punëtori dhe se punëtorët që kanë qenë të pranishëm në lokal nuk kanë qenë në dijeni për këtë fakt dhe nuk kanë pasur kompetencë. Më tutje ka theksuar se inspektorët nuk e kanë thirrë atë në cilësinë e pronarit dhe nuk i kanë lënë afat për dorëzimin e dokumentacioneve të kërkuara, mirëpo menjëherë i kanë shqiptuar masën ndëshkimore. Më tutje ka deklaruar se përmbaruesi me rastin e lëshimit të urdhrin nuk e ka vërtetuar gjendjen e plotë faktike dhe se urdhri është lëshuar në mënyrë të kundërligjshme sepse nuk është i bazuar në prova dhe nuk është interpretuar në mënyrë të drejtë as e drejta materiale si dhe nuk janë vërtetuar si duhet normat juridike dhe provat e nevojshme lidhur me të njëjtën. Po ashtu në rastin konkret ka shtuar se kreditori është dashur që të ja lë një afat të caktuar debitorit dhe ti shqiptoj gjobën vetëm në rast se mos përgjigjes nga ana e debitorit. Në fund i ka propozuar gjykatës që të aprovoj

prapësimin, të shfuqizoj urdhrin dhe të hudhë poshtë propozimin deri në vendimin përfundimtar të Gjykatës Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative.

Kreditori nuk ka paraqitur përgjigje në prapësim.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim dhe pas shqyrtimit dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligji Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbaremore, (tutje LPP) gjeti se prapësimi i debitorit është pjesërisht i bazuar dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se organi përmbareues ka lejuar përmbareimin bazuar në nenin 21 të LPP-së i cili përcakton se: *“Organi përmbareues e cakton, përkatësisht e zbaton përmbareimin vetëm në bazë të dokumentit përmbareues (titulus executionis) dhe dokumentit të besueshëm, po qe se me këtë ligj nuk është parashikuar diçka tjetër.”*

Gjykata ka shqyrtuar dokumentin përmbareimor, përkatësisht Vendimin Nr. 271/19, në bazë të së cilit përmbareuesi privat ka lejuar përmbareimin dhe gjeti si i njëjti, sipas nenit 22 paragrafit 1, nën paragrafi 1.2 të LPP-së, është përcaktuar si dokument përmbareues sipas të cilit mund të caktohet përmbareimi për realizimin e kërkesës në të holla. Po ashtu Vendimi Nr. 271/19, i përmban të gjitha elementet e përcaktuara në nenin 27 paragrafin 1, sipas të cilit: *“Dokumenti përmbareimor është i përshtatshëm për përmbareim në qoftë se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit”,* pasi që në të është treguar kreditori, debitori, objekti, mjetet, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret Vendimin Nr. 271/19, i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 36 paragrafin 1 të LPP-së, sipas të cilit përcaktohet se: *“Së bashku me propozimin për përmbareim, organit përmbareues i dorëzohet edhe dokumenti përmbareues, origjinal apo kopje e vërtetuar, me klauzolën e përmbareueshmëris për përmbareueshmëri”,* dhe paragrafin 2 të këtij neni, sipas të cilit përcaktohet se: *“Vërtetimin për përmbareueshmërin e jep Gjykata, respektivisht organi shtetëror që ka vendosur për kërkesën në procedurën e shkallës së parë”,* ngase Vendimi Nr. 271/19 i datës 12.11.2019, i nxjerrë nga Inspektorati i Punës, është bërë i formës së prerë me datë 27.01.2020 dhe i ekzekutueshëm me datë 27.01.2020

Gjykata shfuqizoi pjesërisht urdhrin përmbarrimor P.nr.239/20, të datës 28.07.2020, të Përmbarruesi Privat Zija Bala, sa i përket pjesës së obligimit të debitorit për pagesën e kamatës së përcaktuar me urdhrin përmbarrimor, pasi që urdhri përmbarrimor nuk është në përputhje me dokumentin përmbarrimor sipas të cilit është lëshuar urdhri për përmbarrim, për faktin se debitori sipas dokumentit përmbarrimor është obliguar që në emër të masës ndëshkimore t'ia paguaj kreditorit shumën prej 1,100.00€ (një mijë e njëqind euro), mirëpo jo edhe pjesën e kamatës ligjore, andaj gjykata vendosi si në pikën I dhe III të dispozitivit të këtij aktvendimi duke shfuqizuar pjesërisht urdhrin sa i përket pjesës së kamatës së kërkuar.

Gjykata i vlerësoi pretendimet e debitorit të paraqitura në prapësim lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së dokumentit përmbarrues dhe gjeti se pretendimet e tilla nuk janë objekt shqyrtimi i procedurës përmbarrimore dhe nuk mund të vlerësohen në këtë procedurë, ngase kjo procedurë i nënshtrohet parimit të rigorozitetit formal, në bazë të së cilit nuk lejohet vlerësimi i rrethanave tjera, përpos vlerësimit të elementeve formale të dokumentit në bazë të cilit është lejuar përmbarrimi, si dhe përshtatshmërisë së vendimit objekt përmbarrimi.

Gjykata po ashtu i vlerësoi pretendimet e debitorit se lidhur me këtë çështje ka iniciuar konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë – Departamenti për Çështje Administrative mirëpo gjeti se vendimi Nr. 271/19 i datës 12.11.2019 përbën dokument përmbarrimor konform nenit 24 par.3 të LPP-së, me të cilën përcaktohet se “ *Vendimi i dhënë në procedurë administrative është përmbarrimor, po qe se i tillë është bërë sipas rregullave me të cilat është rregulluar procedura e tillë.*”, dhe bazuar në dispozitën e nenit 22 të Ligjit Nr. 03/L-202 për Konfliktet Administrative, me të cilën është përcaktuar se: “ *Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe*”, rezulton se paraqitja e padisë nuk paraqet pengesë për ekzekutimin e aktit administrativ në procedurën përmbarrimore dhe si rrjedhojë nuk e ndalon përmbarrimin.

Nga arsyet e paraqitura më lartë, dhe duke u bazuar duke u bazuar në 73 par.1 dhe par. 3 të LPP-së, nenin 12 par. 2 të Ligjit Nr.05/L-118 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr.04/L-139 për Procedurën Përmbarrimore dhe nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE, Dhomat e Shkallës së Parë

Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.543/22, datë 06.09.2022

Gjyqtari

Hasan Kryeziu

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi  
palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve,  
nga dita e pranimit të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë,  
në Gjykatën Komerciale, në Prishtinë, përmes Dhomave të Shkallës së parë të kësaj Gjykate.